



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://ëëë.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Raporti i Punës i Fakultetit Juridik për vitin 2021

I. Procesi i Akreditimit

Fakulteti Juridik në kuadër të UIBM, është akredituar me vendimin nr. 548/14, të datës 04.07.2014, i lëshuar nga Këshilli Shtetëror i Cilësis (KSHC) i Agjencionit të Kosovës për Akreditim (AKA).

Fakulteti Juridik është ri-akredituar me Vendimin nr. 535/2017, të datës 06.07.2017, nga Këshilli Shtetëror i Cilësis (KSHC) i Agjencionit të Kosovës për Akreditim (AKA), për periudhën 3 vjeçare.

Vizita e Ekspertëve të AKA-së në Fakultetin Juridik është realizuar më datë 26.05.2017.

Implementimi i rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve Ndërkombëtar ka filluar të realizohet nga muaji shtator 2017.

Programi i ri-akredituar ka adresuar të gjitha kërkesat nga procesi paraprak i akreditimit.

Ndërkohë, me Vendimin nr. 465/18D, të datës 18.05.2018, e Këshilli Shtetëror i Cilësis (KSHC) të Agjencionit të Kosovës për Akreditim (AKA), është zgjatuar periudha e akreditimit edhe për 1 (një) vit, deri më 30 (tridhjetë) shtator 2021.

Fakulteti Juridik është ri-akredituar me Vendimin nr. 3022/21, të datës 12.08.2021, nga Këshilli Shtetëror i Cilësis (KSHC) i Agjencionit të Kosovës për Akreditim (AKA), për periudhën 3 vjeçare.

Vizita e Agjencionit të Kosovës për Akreditim (AKA) dhe Ekspertëve Ndërkombëtar në Fakultetin Juridik është realizuar më datë 22.03.2021.

Programi i ri-akredituar ka adresuar të gjitha kërkesat nga procesi paraprak i akreditimit.

Implementimi i rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve Ndërkombëtar ka filluar të realizohet nga muaji nëntor 2021.

II. Mbajtja e mësimit

Në vitin 2021, Fakulteti Juridik ka realizuar procesin mësimor, fillimisht është vendosur mbajtja e procesit mësimor të kombinuar, në atë online dhe fizik. Kjo menyrë e mbajtjes së mësimit është zbatuar në bazë të vendimeve të nxjerrura nga institucionet kompetente të Republikës së Kosovës, duke respektuar masat e mbrojtjes nga COVID - 19.

Mësimi fillimisht nga data 16.02.2021 është zhvilluar fizikisht. Kjo mënyrë e mesimdhënies ka zgjatuar deri më datë 07.04.2021, kur Qeveria e Republikës së Kosovës ka udhëzuar mbajtjen e procesit mësimor në mënyrë virtuale/online. Zgjatja e mesimit online ishte caktuar deri më datë 18.04.2021.

Nga data 19.04.2021 deri më datë 30.04.2021, mënyra e mbajtjes së mësimit në Fakultetin Juridik është zhvilluar në formen fizike. Ndërsa, nga kjo datë është vendosur nga menaxhmenti i Fakultetit Juridik që mësimi në tërësi deri në fund të semestrit të zhvillohet vetëm në mënyrën virtuale/online. Mësimi ka përfunduar me suksese duke u realizuar në tërësi planprogrami i njesisë sonë akademike për vitin akademik 2020/2021. Në semestrin veror 2021 mësimi është zhvilluar në 15 javë. Realizimi i mësimit online është zhvilluar në 8 javë, ndërsa mësimi fizik në kampus në 7 javë. Mbajtja e ligjëratave në përqindje është si vijon: në mënyrë online mësimi është realizuar 56.25%, ndërsa mësimi fizik në kampus është realizuar 43.75%.

Ndërsa në vitin e ri akademik 2021/2022, Semestri Dimëror, mbajtja e Ligjëratave dhe Ushtrimeve kanë filluar me dy javë vonesë si pasojë e vendosjes së masave anti COVID -19 nga Institucionet e Republikës së Kosovës dhe Vendimit të UIBM. Ligjëratat dhe Ushtrimet kanë filluar më datë 15.10.2021 në formën fizike dhe deri më tani tërë procesi është zhvilluar sipas

orarit dhe planit të përcaktuar. Zëvendësimi i Ligjëratave dhe Ushtrimeve nga Profesorët për dy javët e para të tetorit është bërë gjatë muajit nëntor në koordinim me menaxhmentin e FJ dhe studentët. Sipas Vendimit të Këshillit të FJ i cili bazohet në rekomandimet e Ekspertëve Ndërkombëtar të ri-akreditimit në disa raste ligjëratat dhe ushtrimet janë mbajtur edhe në formen Online.

Në rastet kur ligjëratat kanë qëlluar në datat e festave zyrtare ato janë zëvendësuar sipas një orari të vendosur nga prodekani për mësim në bashkëpunim me profesorin e lëndës përkatëse. Sigurisht një zëvendësim i tillë ka marr parasysh edhe orarin e studentëve në lëndët e tjera në mënyrë që kjo të mos ngarkojë ata në procesin mësimor.

III. Mbajtja e provimeve

Organizimi i provimeve është bërë sipas afateve të caktuara me Statutin e Universitetit dhe Vendimeve të Senatit të Universitetit.

Provimet janë mbajtur fizikisht, me shkrim, me gojë ose në formë kombinuar. Mënyra e kombinuar e provimeve me gojë dhe me shkrim është zbatuar në të gjitha afatet, janar, prill, qershor, shtator, tetor (afat i jashtëzakonshëm) dhe nëntor (afat për apsolventë). Kjo formë e mbajtjes së provimeve është bërë me qëllim të zhvillohen shkathtësitë e nevojshme të shprehurit tek studentët, si dhe të matet me saktësi shkalla e njohjes së lëndës konkrete. Kjo metodë ka dhënë rezultate e saja, pasi sipas deklarimeve të studentët ka ndikuar që ata të vijnë më të përgatitur në provime.

IV. Procesi i regjistrimit të studentëve

Duke pasur parasysh përcaktimin e numrit të studentëve në Vendimin nr. 3022/21, të datës 12.08.2021 nga Këshilli Shtetëror i Cilësis (KSHC) i Agjencionit të Kosovës për Akreditim (AKA), në vitin akademik 2021/2022 në Fakultetin Juridik janë regjistruar 74 studentë të rinjë dhe dy studentë transfer.

V. Angazhimi i stafit akademik të rregulltë dhe të jashtëm

Gjatë vitit 2021, kanë qenë në marrëdhënie të rregullt dhe të angazhuar të punës këta profesorë dhe asistentë:

Stafi Akademik në marrëdhënie të rregullt pune:

Profesorë të asociuar:

1. Prof. asoc. dr. Agron Beka
2. Prof. asoc. dr. Islam Qerimi
3. Prof. asoc. dr. Halil Bajrami

Profesorë asistentë:

1. Prof. ass. dr. Arta Dauti
2. Prof. ass. dr. Mimoza Aliu
3. Prof. ass. dr. Përparim Gruda
4. Prof. ass. dr. Zahir Çerkini
5. Prof. ass. dr. Besnik Murati
6. Prof. ass. dr. Arbnor Ajeti

Asistentë:

1. Ass. LL.M. Xhemajl Veliqi, PhD.Cand.

Stafi akademik me angazhim:

1. Prof. dr. Beqir Sadikaj
2. Prof. ass. dr. Ylber Januzaj
3. MSc. ass. Milaim Mehmeti

VI. Puna e Këshillit të Fakultetit

Këshilli i Fakultetit Juridik gjatë vitit 2021 ka mbajtur gjithsej 19 mbledhje. Gjatë këtyre mbledhjeve është diskutuar dhe vendosur për një sërë çështjes si: Emërtimi i programit Master të Fakultetit Juridik dhe formimi e grupit punues për hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit për këtë program; Miratimi i Syllabuseve të shqyrtuara nga Komisioni i Studimeve i FJ; Propozimi i anëtarit të Këshillit të Etikës në kuadër të Universitetit “Isa Boletini”; Formimi i Këshillit të Institutit për Studime dhe Hulumtime Juridike dhe Ligjore; Miratimi i Planit të implementimit të rekomandimeve të dhëna në Raportin final të Ekspertit ndërkombëtar në procesin e ri-akreditimit për Fakultetin Juridik të hartuar nga Grupi Punues; Propozimet dhe miratimi i botimeve nga stafi akademik për Këshillin Botues të UIBM për vitin akademik 2021/2022; Formimi i TASK FORCËS për mbikëqyrjen e mësimit të kombinuar pas COVID- 19; Shqyrtimi dhe miratimi i vendimeve të komisionit të studimeve për ndryshimin e programit të studimeve për disa studentë; Mbajtja e konferencës online nga Fakulteti Juridik “Të drejtat e njeriut, kriminaliteti dhe ekonomika në kohë të pandemisë COVID-19”.

VII. Organizimet brenda fakultetit

Gjatë vitit 2021 është realizuar vizita e Agjencionit të Kosovës për Akreditim (AKA) dhe Eksperteve Ndërkombëtarë në Fakultetin Juridik me datë 22.03.2021, për mbrojtjen e programit të FJ për ri-akreditim. Ky proces është realizuar në mënyrë të suksesëshme, ku e deshmon edhe vlerësimi i lartë nga Ekspertët Ndërkombëtar dhënë programit Juridik. Gjatë muajit tetor dhe fillimi i nëntorit është finalizuar plani i implementimit të rekomandimeve të dhëna në raportin final të Ekspertëve Ndërkombëtar në procesin e ri-akreditimit për Fakultetin Juridik. Implementimi i rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve Ndërkombëtar ka filluar të realizohet nga muaji nëntor 2021.

Eshtë realizuar vizit e studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë në Gjykatën Themelore të Prishtinës – Departamenti për Krime te Rënda, për raste nga fusha penale.

Gjithashtu, është zhvilluar cikli i trajnimeve në kuadër të projektit “Luftimi i Urrejtjes në Kosovë”, i cili është implementuar nga ATRC në partneritet me RADC dhe i mbështetur nga

Ambasada Holandeze në Kosovë. Studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë janë trajnuar mbi proceset e avokimit dhe ndikimit në vendimmarrje.

Është bërë harmonizimi i pyetësoreve për Studentët, Alumni dhe Palët e Inetersit sipas programit të Fakulteti Juridik, në kordinim dhe sipas kërkesës të Zyrës për Cilësi në kuadër të UIBM. Po ashtu, është bërë harmonizimi i Treguesëve të Përformancës sipas programit të Fakulteti Juridik në kordinim dhe sipas kërkesës të Zyrës për Cilësi në kuadër të UIBM.

Dhënia e kontributit nga përfaqësuesit e deleguar nga Fakulteti Juridik me propozime konkrete gjatë hartimit të Planit Strategjik Kërkimor të UIBM.

VIII. Bashkëpunimi i Fakultetit Juridik në nivelin kombëtarë dhe ndërkombëtar

Janë organizuar takime të Menaxhmentit të FJ-së, me qëllim të arritjes së memorandumeve të bashkëpunimit të njësisë tonë akademike me institucionet e ndryshme publike dhe private të Republikës së Kosovës dhe në nivel ndërkombëtar.

Memorandumet e arritura të bashkëpunimit në mes Fakultetit Juridik dhe atyre publike dhe private janë:

- Fakulteti Juridik dhe Byroja Kosovare e Sigurimit;
- Fakultetit Juridik dhe Avokatit të Popullit;
- Më datë 24.12.2021, Fakulteti Juridik është pranuar si anëtare e SHOQATËS EVROPIANE TË FAKULTETEVE JURIDIKE me seli në Belgjikë e cila ka mbi 150 anëtarë.

IX. Organizimi i Konferencave Shkencore nga Fakulteti Juridik

Më datë 20.12.2021 është mabjtur Konferenca Shkencore e organizuar nga Fakulteti Juridik në formen virtuale/online “Të drejtat e njeriut, kriminaliteti dhe ekonomia në kohë të pandemisë COVID -19”, ku u paraqitën 40 kumtesa nga pjesëmarrësit nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia.

Përzgjedhja e abstrakteve/kumtesave ka kaluar nëpër një filtër seleksionimi të cilën e ka bërë KOMISIONI VLERËSUES. Poashtu, konferenca shkencore ka qenë e mbikëqyrur nga

KËSHILLI ORGANIZATIV që e kanë përbërë 15 dr.sc., nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia.

X. Publikime shkencore, pjesmarrje në Konferenca Shkencore, Trajnime të Stafit Akdemik, Profesorë/Ekspertë të ftuar si mysafir-folës gjatë Ligjëratave

Gjatë vitit 2021, i tërë Stafi Akademi i Fakultetit Juridik në total ka publikuar 6 (gjashtë) Punime Shkencore, ka marrë pjesë në 17 (shtatëmbëdhjetë) Konferenca Shkencore, ka ndjekur 9 (nëntë) Trajnime dhe kanë qenë të ftuar 15 (pesëmbëdhjetë) Profesorë/Ekspertë si Mysafir-folës.

XI. Investimet në projekte kapitale, mallra dhe shërbime

Gjatë vitit 2021 stafi akademik dhe administrativ ka pranuar gjithësej 5 (pesë) kompjuterë.

Prof. Asoc. Dr. Agron BEKA

Dekan

Ky raport i dorëzohet:

- 1. Rektorit të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”;*
- 2. Prorektorit për mësim të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”;*
- 3. Arkivit të Fakultetit.*